



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2814 Prot.

Vlorë, më 30.12.2019

VENDIM

Nr. 16, datë 27.12.2019

PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR “NDERI I QARKUT VLORË”
Z. ABAZ TAHIR HOXHA

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.12.2019 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 112/2014 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM - së Nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 23, datë 20.07.2017 për miratimin e Rregullores mbi procedurat e dhënies së “Titujve Vendorë të Nderit”, propozimit të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Tragjasi” si dhe Vendimit të Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë më datë 16.10.2019;

VENDOSI;

1. Dhënien e Titullit Vendor “Nderi i Qarkut Vlorë” z. Abaz Tahir HOXHA me motivacion “Për kontributin e çmuar në krijimin, zhvillimin dhe rritjen e vlerave të artit dhe kinematografisë shqiptare”.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.